



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.963, datë 04.09.2009

**Për revokim te VKD nr.796, dt.20.07.2009, për dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit
“VELAJ” sh.p.k.**

Këshilli Drejtues i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në mbledhjen e datës 04.09.2009, sipas rendit të ditës dhe procedurës së përcaktuar në nenin 7 e në vijim të Rregullores së Brendshme në fuqi, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar me Vendim të Këshillit Drejtues Nr. 452, datë 02.05.2008, bazuar në ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 115 “Marrja e Vendimeve dhe Struktura e Këshillit Drejtues”, mori në shqyrtim:

Propozimin e Drejtorisë së Licensimit për revokimin e VKD nr.796, dt.20.07.2009, për dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit “VELAJ” sh.p.k.

BAZA LIGJORE :

- Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
- Neni 121 e në vijim i Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”.
- Rregullorja për Autorizimin Individual miratuar me VKD Nr. 510 datë 04.11.2008;

Ne përfundim të interpretimit të bazës ligjore, materialit të paraqitur nga Drejtoria e Licensimit

VËREHET SE :

Sipërmarrësi “Velaj” sh.p.k. ka depozituar kërkesën nr.718, dt.04.02.2009, për caktim frekuencash sipas rregullores për Autorizim Individual, për sistem radiokomunikimi në brezin VHF, me zone gjeografike rrethi Vlore.

Kërkesa e lartpërmendur, mbas shqyrtimit të drejtorive përkatëse, është propozuar për shqyrtim dhe miratim në KD me relacionin nr.1401, datë 17.03.2009.

Në vijim sipërmarrësi “Velaj” sh.p.k. me kërkesën nr.2005, datë 06.05.2009, ka kërkuar caktim frekuencash sipas rregullores për Autorizim Individual për sistem radioalarmi në brezin VHF me zone gjeografike qyteti Vlore.

Propozimi i dhënë nga Drejtoria e Licensimit në relacionin nr.1401, dt.17.03.2009 në të cilën përfshihet kërkesa nr.718, dt.04.02.2009 e sipërmarrësit nuk ishte marrë në shqyrtim nga Këshilli Drejtues.

Drejtorja e Licensimit me relacionin nr.2346, dt.01.06.2009 propozoi që të merreshin në shqyrtim nga KD të dy kërkesat e bëra nga sipërmarrësi “Velaj” sh.p.k. (kërkesa nr.718, dt.04.02.2009 dhe kërkesa me nr.2005, dt.06.05.2009)

Ne mbledhjen e Këshillit Drejtues te datës 20-21 Korrik 2009 te dy relacionet e propozuara nga Drejtoria e Licensimit janë marre ne shqyrtim pavarësisht njeri tjetrit dhe

Për sipërmarrësin “VELAJ”sh.p.k jane miratuar përkatësisht këto vendime:

1. VKD nr.796, dt.20.07.2009, i cili përfshin kërkesën nr.718, dt.04.02.2009.
2. VKD nr.885, dt.20.07.2009, i cili përfshin te dy kërkesat nr.718, dt.04.02.2009 dhe nr.2005, dt.06.05.2009.

Ne përfundim te interpretimit te bazës ligjore dhe materialit te propozuar nga Drejtoria e Licensimit, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I :

1. Te revokojë Vendimin Nr.796, dt.20.07.2009 te Këshillit Drejtues me te cilin eshte miratuar Autorizimi Individual per sipërmarrësin “**VELAJ**” sh.p.k.
2. Ngarkohen Drejtoria e Licensimit dhe Drejtoritë e tjera te AKEP për ndjekjen e efekteve qe rrjedhin nga ky vendim.

KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES

Ilir SHEHU

Anëtarë të Këshillit Drejtues:

1. **Afrim TONUZI**
2. **Edlira KASAJ**
3. **Ilir ZELA**
4. **Jetmir KARINI**